



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.507/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e parashtruar nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me shenjën ZL.A.nr.507/2017 e datë 25.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 24.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka pretenduar se rezultatet e zgjedhjeve janë të manipuluar dhe se në listat e publikuara nga KKZ-ja, nuk e pasqyrojnë numrin e votave të fituara nga kandidatet në mënyrë individuale dhe kjo dëshmohej edhe nga raportet e komisionerëve dhe vëzhguesve të PDK-së dega në Prishtinë. Gjatë analizimit të procesit të numërimit kanë vërejtur se ekzistojnë formularët të panënshkruar nga personat përgjegjës dhe se dyshojnë se në qendrat e numërimit ju janë marrë votat e kandidatëve të PDK-së. Me këtë rast kandidatet për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga radhët e subjektit politik PDK kanë kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave.

Ankesës ia ka bashkangjitur listën e nënshkruar nga kandidatet për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë sepse, pretendimet ankimore që ndërlidhen me rezultatin e votimit duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës.

Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës e subjektit politik PDK, nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.507/2017 më datën 25.10.2017.

Kryesuesi i Panelit

Gyltene Sylejmani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.